

VENDIM
Nr. 933, datë 26.12.2012

PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12 të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2013, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 910, datë 28.12.2011, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2012”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha